

KËRKIME GJUHËSORE

Enkeleida KAPIA

DYFISHIMI I KUNDRINËS ME TRAJTË TË SHKURTËR NË SHQIPEN E FËMIJËVE SHQIPFOLËS

Abstract: This study investigates the role of syntax and pragmatics in early acquisition by looking at children's knowledge of syntax and information structure of clitic doubling in very early Albanian. Specifically, this study reports on the acquisition of clitic doubling of both dative and accusative objects in child language. The results of the studies reported here expand the literature of clitic doubling in crosslinguistic acquisition with data from dative clitics and offer support for the modular nature of language with syntax present from age 2;0 and pragmatics or the interface between pragmatics and syntax not fully matured until after age 4;0. In other words, these studies suggest mastery of syntax from really early stages of acquisition, while production of information structure appears to occur later in language development.

1. Hyrje: Kërkimet shkencorë në fushën e përvetësimit të gjuhës janë përqendruar tradicionalisht jo vetëm se si modulet autonome të gjuhës, p.sh. sintaksa, morfologjia, pragmatika, ndërveprojnë me domenet konjitive, por gjithashtu janë përqendruar edhe në mënyrën se si këto module ndërveprojnë me njëri-tjetrin përgjatë procesit të zhvillimeve të hershme të gjuhës (p.sh. Chomsky, 1975; Landau and Jackendoff, 1993; Maratsos, 1974; Grinstead, 2004; Schaeffer, 2000; Avrutin, 1994). Një arritje me rëndësi nga ky vëllim i dendur pune është që modulet e ndryshme gjuhësore, edhe pse autonome në vetvete, mund të ndikojnë në mënyrën se si dukuritë gjuhësore që gjenden në pikëprerjen e dy moduleve të ndryshme manifestohen në gjuhën e fëmijëve. Në vazhdim të kësaj linje kërkimore, ky studim ka për qëllim të shqyrtojë rolin që pragmatika luan në përvetësimin e dukurive sintaksore, duke marrë në konsideratë përvetësimin e dukurisë së dyfishimit të kundrinës dhanore dhe kallëzore me trajtë të shkurtër (këtej e tutje do të quhet *kliticizim*) në shqipen e fëmijëve. Ky lloj kliticizimi përbën një dukuri gramatikore të veçantë për vetë arsyen se realizimi dhe distribucioni i tij në shqip herë-herë kushtëzohet nga sintaksa dhe herë-herë kushtëzohet si nga sintaksa, ashtu edhe nga pragmatika.

Më konkretisht, kundrinat kallëzore në shqip janë domosdoshmërisht të kliticizuara në disa kontekste dhe domosdoshmërisht të pakliticizuara në kontekste të tjera. Kliticizimi i kundrinës kallëzore ka lidhje të drejtpërdrejtë me teorinë e gjymtyrëzimit aktual. Kur kundrina shërben si temë në ligjërimin ku gjendet, atëherë ajo kundrinë është gjithmonë e kliticizuar, ndërsa kur kundrina shërben si fokus, atëherë ajo kundrinë nuk është e kliticizuar (Kallulli 1995, 2000; Kapia, 2010, Kapia, 2012). Ky trajtim ndryshon nga trajtimet tradicionale të teorisë së gjymtyrëzimit aktual në shqipe të trajtuara në Gramatikën e Akademisë, por ky ndryshim teorik nuk është objekti i këtij studimi. Në kontrast me kundrinat

kallëzore, kundrina dhanore është gjithmonë e kliticizuar. Shembujt 1-3 ilustrojnë këto dukuri.

- (1) Ne i blemë librat.
- (2) Ne blemë librat.
- (3) Ne *(i) folëm babait.

Me fjalë të tjera, kliticizimi i kundrinave dhanore është i kushtëzuar nga sintaksa, ndërsa kliticizimi i kundrinave kallëzore është i kushtëzuar në realizimin e vet si nga sintaksa, ashtu edhe nga pragmatika. Si i tillë, studimi i përvetësimit të këtyre llojeve të kliticizimit në shqipe hap një dritare në studimin e rolit të sintaksës dhe pragmatikës në procesin e zhvillimit të gjuhës, si edhe zbulon me tepër për vetë natyrën idiosinkretike të këtyre dy moduleve gjuhësore. Studimi i paraqitur këtu është ideuar që të adresojë të dyja këto çështje teorike.

2. Studimi

2.1 Pjesëmarrësit

Pjesëmarrësit në këtë studim qenë 40 fëmijë monolingualë të shqipes nga qyteti i Tiranës nga mosha 2;0 deri në 4;0 vjeç, të cilët u ndanë në 4 grupe moshore me diferencë 6 muaj. I njëjti eksperiment i kryer me këta fëmijë u krye edhe me 30 pjesëmarrës të rritur me qëllim që të krijohet një standard statistikor për pritshmërinë mbi studimin e fëmijëve.

2.2 Materialet

Dyzet e tetë ilustrime me ngjyra që u përdorën, tregonin veprime të kryera nga disa personazhe të njëjta. Ilustrimet u renditën ndryshe në tre libra të veçantë, të cilët u ndanë në mënyrë që pjesëmarrësi i tretë në çdo tre pjesëmarrës të kishte të njëjtin libër. Kushtet eksperimentale ndryshonin sipas dy dimensioneve: rasës dhe fokusit. Materialet e testimit ishin ose në rasën dhanore, ose në atë kallëzore. Sipas dimensionit të fokusit, materialet ishin ose fokus, ose temë.

2.3 Procedura

Materialet e përshkruara me sipër u përdorën në një formë hibride testimi, atë të Gjikimit të Vlerës Semantike dhe Prodhimit të elicituar¹, detyrë kjo e mbështetur në të njëjtën detyrë të përdorur nga Schaeffer (2000).

3. Analiza dhe Rezultatet

Përgjigjet e pjesëmarrësve u koduan për përdorim të drejtë dhe të padrejtë të kliticizimit. Pesha statistike e rezultateve u përllogarit duke përdorur Generalized Estimating Equations (GEEs). Tabela 1 paraqet rezultatet e kliticizimit për kundrinën dhanore dhe kallëzore. Rezultatet janë paraqitur sipas moshës dhe dy rasave në fjalë.

Tabela 1 Kliticizimi i rasës dhanore dhe kallëzore

Grup-mosha	dhanore		kallëzore	
	shifrat	përqindjet	shifrat	përqindjet
2;0-2;6	187/195	95.8%	201/236	85.2%
2;6-3;0	193/197	98%	201/237	84.2%

¹ Elicitimi është procesi i nxjerrjes në pah me anë të pyetjes përkatëse të një përbërësi të caktuar sintaksor.

DYFISHIMI I KUNDRINËS ME TRAJTË TË SHKURTËR NË SHQIPEN E
FËMIJËVE SHQIPFOLËS

3;0-3;6	222/225	98.7%	201/239	84.1%
3;6-4;0	218/222	98.2%	214/238	90%
Të rriturit	719/719	100	702/720	98%

Këto rezultate tregojnë një asimetri midis kliticizimit të rasës dhanore dhe atij të kallëzores, me përqindjen me të lartë të rasteve të sakta në rasën dhanore. GEE tregon që statistikisht fëmijët performojnë njësoj si të rriturit vetëm nëse kundrinat janë në rasën dhanore dhe jo kur ato janë në rasën kallëzore ($p < .001$). Është për t'u theksuar këtu që analiza statistikore tregon që edhe dyvjeçarët e kanë këtë aftësi për sa i përket kliticizimit të rasës dhanore.

Por, modeli statistikor tregon që kjo kurbë nuk është e njëjtë për rasën kallëzore. Kliticizimi i kundrinës në rasën kallëzore, sipas analizës statistikore, nuk është i njëjtë me atë të të rriturve. Me fjalë të tjera, ky kliticizim është ende i papërvetësuar nga fëmijët e moshave të studiara këtu. Gjithashtu, analizat statistikore tregojnë që kjo kurbë e përvetësimit të kliticizimit të kundrinës së rasës kallëzore nuk përmirësohet statistikisht nga mosha 2 deri në moshën 4 vjeç. Kjo do të thotë që si fëmijët e moshës 2-vjeçare, ashtu edhe ata të moshës 4-vjeçare performojnë me ritme pak a shumë të njëjta për sa i përket saktësisë në këtë lloj kliticizimi.

Por lind pyetja: Çfarë e shkakton mospërvetësimin e kliticizimit të kundrinës në rasën kallëzore nga fëmijët e kësaj moshe? A ndodh ky mospërvetësim në rastin kur kundrina është fokus apo në rastin kur kundrina është temë? Apo mos ndodh në të dyja rastet? Një shqyrtim i mëtejshëm i rezultateve të paraqitura në Tabelën 2 më poshtë, na çon në disa përfundime. Së pari, është e qartë që fëmijët performojnë shumë më mirë me kliticizimin në rastin kur kundrinat e rasës kallëzore janë tema dhe jo kur ato janë fokus. Në fakt, duket qartë që fëmijët, përveçse i përdorin drejtë trajtat e shkurtra kur këto kundrina janë tema, ata i mbipërdorin trajtat e shkurtra edhe në rastin kur kundrinat në kallëzore janë fokus. Së dyti, nuk ka asnjë ndryshim statistikor midis performancës së fëmijëve dhe performancës së të rriturve në rastin e kliticizimit të kundrinës në kallëzore kur është temë. Kjo do të thotë që fëmijët i përdorin trajtat e shkurta në këto raste njësoj si të rriturit dhe me saktësinë e gramatikës së të rriturve. Por, duhet thënë që ka një ndryshim statistikor midis performancës së fëmijëve dhe performancës së të rriturve në rastet e kliticizimit të kundrinave në kallëzore kur ato janë fokus (p -value $< .001$).

Tabela 2 Kliticizimi i kundrinave në kallëzore kur janë temë dhe fokus

grupmosha	temë	fokus		
		përqindjet	përqindjet	
2;0-2;6	74/79	93.6%	127/157	80.8%
2;7-3;0	73/79	92.4%	128/158	81%
3;1-3;6	74/79	97.4%	127/160	79.4%
3;7-4;0	77/79	98.2%	137/159	86.2%
Të rriturit	233/240	97.1%	469/480	97.7%

Gjithashtu, modelet GEE tregojnë që performanca e fëmijëve për rastet e kundrinave fokus (në kallëzore) nuk përmirësohet duke u rritur. Pra, as në moshën 4 vjeç, që është mosha më e lartë e fëmijëve të studiuar këtu, nuk shohim përafrim të saktësisë së përdorimit të kliticizimit të kundrinës kallëzore në fokus me atë të gramatikës së të rriturve.

4. Diskutime dhe Përfundime

Detyra e përdorur në këtë studim me fëmijët shqipfolës të moshës 2-4 vjeç u ndërtua për të shqyrtuar rolin e sintaksës dhe të pragmatikës në përvetësimin e hershëm të gjuhës në rastin e kliticizimit të kundrinave në dhanore dhe kallëzore. Rezultatet e këtij studimi tregojnë që fëmijët, qoftë edhe ata dyvjeçarë, e përdorin dukurinë sintaksore të kliticizimit të kundrinës dhanore njësoj si në gramatikën e të rriturve. Ky përfundim sugjeron që fëmijët, qysh prej moshës dyvjeçare, e kanë përvetësuar mënyrën e realizimit të rasës dhanore. Këtu është e rëndësishme të theksohet që me anë të këtij vërtetimi vëmë re që fëmijët jo vetëm që e kanë përvetësuar shumë mirë realizimin e klitikëve të rasës dhanore, por edhe në sistemin e tyre gjuhësor të hershëm nuk ekziston asnjë pengesë sintaksore që të bllokojë realizimin e kësaj dukurie gramatikore. Me fjalë të tjera, sistemi sintaksor që bën të mundur realizimin e kliticizimit të rasës dhanore është tërësisht i formuar në këto grupmosha.

Por pavarësisht nga performanca e tyre në kliticizimin e kundrinës në rasën dhanore, fëmijët e kësaj moshe ende bëjnë gabime me kliticizimin e kundrinës në rasën kallëzore. Ata e përdorin trajtën e shkurtër edhe në rastin kur kundrina në kallëzore është fokus, gjë që nuk është e mundur në sistemin gramatikor të të rriturve. Ky lloj mbipërdorimi i trajtave të shkurtra kërkon një lloj shpjegimi. Çfarë e motivon këtë mbipërdorim? Mos ndoshta sintaksa që është e përgjegjshme për realizimin e kliticizimit të kundrinës kallëzore është ende e pazhvilluar? Mos ndoshta ky mbipërdorim motivohet nga faktorë që vijnë nga moduli i pragmatikës? Apo mos ndoshta pikëprerja e sintaksës dhe pragmatikës në gjuhën e fëmijëve në këtë moshë është ende e paformuar plotësisht?

Për të shpjeguar arsyet e këtij mbipërdorimi, sjellim në kujtesë nga të dhënat e mësipërme që fëmijët kliticizojnë kundrinat në kallëzore që janë temë po aq mirë sa edhe të rriturit. Me fjalë të tjera, kliticizimi i kundrinës kallëzore që është temë është i ngjashëm me atë të kundrinave në dhanore dhe si i tillë, prodhimi i këtij kliticizimi vjen si rezultat i një sistemi sintaksor tërësisht të formuar. Gjithashtu, fëmijët kliticizojnë kundrina që të rriturit i klasifikojnë si tema, gjë që do të thotë se fëmijët e perceptojnë temën njësoj si të rriturit dhe i kliticizojnë kundrina temë. Me fjalë të tjera, në sistemin gramatikor të fëmijëve koncepti sintaksor dhe pragmatik i temës funksionon njësoj si në sistemin gramatikor të të rriturve. Por çfarë ndodh me kundrinat kallëzore që janë fokus? Pse ndodh që fëmijët përdorin trajtat e shkurtra edhe me këto kundrina?

Për t'ju përgjigjur kësaj pyetje duhet t'i shqyrtojmë rezultatet e këtij studimi në lidhje me ndërveprimin e njohurive sintaksore dhe pragmatike që ka

DYFISHIMI I KUNDRINËS ME TRAJTË TË SHKURTËR NË SHQIPEN E FËMIJËVE SHQIPFOLËS

sistemi gramatikor i fëmijëve në këtë moshë. Në bazë të kësaj ndërlidhjeje, mund të themi që kliticizimi i kundrinës fokus në kallëzore ka dy shpjegime të mundshme: 1) vjen si pasojë e një sistemi të pazhvilluar pragmatik dhe 2) vjen nga një pikëprerje e pazhvilluar tërësisht e sintaksës dhe pragmatikës. Në rastin e një sistemi të pazhvilluar pragmatik, fëmijët i mbipërdorin trajtat e shkurtra sepse nuk mund të dallojnë se cili informacion në ligjërim përbën temë ose fokus. Pra, ata nuk mund të dallojnë se cilat informacione në ligjërim janë të reja ose të vjetra. Kjo mundësi shpjegimi është në përputhje me rezultatet e studimeve të mëparshme që sugjerojnë një sistem pragmatik të pazhvilluar brenda sistemit gramatikor të fëmijës (p.sh. Maratsos, 1974; Avrutin, 1994; Schaeffer, 2000; Grinstead, 2004).

Në rastin e një sistemi të pazhvilluar të pikëprerjes së sintaksës dhe pragmatikës, sistemi gramatikor pragmatik i fëmijës i dallon qartë temat dhe fokuset, por nuk është në gjendje që këtë informacion t'ia përçojë qartë sintaksës e cila bën ose jo kliticizimin e kundrinës, sipas rastit.

Pra, në këtë studim, vihet re që ndërkohë që sistemi sintaksor paraqitet tërësisht i zhvilluar në realizimin dhe distribucionin e kliticizimit të kundrinave temë dhe fokus, sistemi pragmatik ose pikëprerja e këtij sistemi me sintaksën rezulton të jetë ende e pazhvilluar në sistemin gjuhësor të fëmijëve të studiuar këtu. Të marra së bashku, përfundimet e këtij studimi flasin për natyrën tepër modulare të strukturave gjuhësore, me sintaksën dhe pragmatikën gjerësisht të përfshira në dukurinë e kliticizimit të kundrinave. Konkretisht, ky studim hedh dritë mbi faktin që sistemi sintaksor që bën të mundur realizimin e dukurisë sintaksore të dyfishimit të kundrinës me trajtë të shkurtër është i lindur. Ndërkaq, sistemi i pragmatikës dhe pikëprerja e tij me sintaksën janë ende në zhvillim e sipër.

BIBLIOGRAFI

- Avrutin, S. (1994). *Psycholinguistic investigations in the theory of reference*. (Doctoral Dissertation, Massachusetts Institute of Technology).
- Babyonyshev, M., & Marin, S. (2006). Acquisition of Pronominal Clitics in Romanian. *Catalan Journal of Linguistics* 5, 17–44.
- Blasco, M. (2000). *The Acquisition of Pronominal Object Clitics in Spanish*. (Doctoral Dissertation, The City University of New York).
- Chomsky, N. (1975). *Reflections on Language*. New York: Pantheon.
- Celiku, M., Domi, M., Floqi, S., Mansaku, S., Pernaska, R., Prifti, S., Totoni, M. (1997). Gramatika e Gjuhës Shqipe II. Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë.
- Grinstead, J. (2004). Subjects and Interface Delay in Child Spanish and Catalan. *Language*, 80, 1, 40-72.
- Kallulli, D. (1995). Clitics in Albanian. *University of Trondheim Working Papers in Linguistics* 24.

ENKELEIDA KAPIA

- Kallulli, D. (2000). Direct Object Clitic Doubling in Albanian and Greek. In Beukema, F., & den Dikken, M. (Eds.) *Clitic Phenomena in European Languages* (pp. 209 – 248). Amsterdam: John Benjamins.
- Kapia, E. (2010). The Role of Syntax and Pragmatics in the Structure and Acquisition of Albanian. ProQuest/UMI Publishing. Ann Arbor, Michigan.
- Kapia, E. (2012). Clitic Doubling and Information Structure in Albanian. *Linguistics*. Mouton de Gruyter.
- Landau, B., & Jackendoff, R. (1993). ‘What’ And ‘Where’ In Spatial Language And Spatial Cognition. *Behavioral & Brain Sciences* 16, 217–26.
- Lyzckowski, D. (1999). *Adquieretelo: On the Acquisition of Pronominal Object Clitics in Spanish*. (Undergraduate Thesis, Harvard University).
- Maratsos, M. (1974). Preschool Children’s Use Of Definite And Indefinite Articles. *Child Development* 45, 446–55.
- Schaeffer, J. (2000) The Acquisition of Direct Object Scrambling and Clitic Placement. John Benjamins, Amsterdam/Philadelphia.